



Pranuar / Dorezuar Prilimjenal/Prilidato Received/Delivary	24-06-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM/SFKK	3703/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.74/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Kocanëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.887/2020 të datës 22.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.74/2020 të datës 06.03.2020, të parashtruar nga ankuesit:

përfaqësojnë avokati dhe të cilët me autorizim i kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *Shpallet jo kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.74/2020 të datës 06.03.2020 të parashtruar nga ankuesit:

dhe

A r s y e t i m

Ankuesit, të punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Arteve, përmes përfaqësuesve me autorizim me datë 06.03.2020 kanë parashtruar ankesë kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë. Me datën 06.12.2019, përfaqësuesit e ankuesve me autorizim kanë parashtruar kërkesë në Këshillin Drejtues për kompensimin e shujtës.

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" pas shqyrtimit të kërkesës me datën 03.02.2020 ka nxjerr vendim me nr.276 me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesve të parashtruar përmes përfaqësuesve të autorizuar.

Të pakënaqur me vendimin e datës 03.02.2020 me nr.276 ankuesit përmes përfaqësuesve me autorizim me datën 06.03.2020 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 614/2020.

Këshilli më datë 19.05.2020 përmes shkresës me numër të protokollit 938/2020, ka njoftuar ankuesit për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e saj të datës 06.03.2020 për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 22.04.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.887/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve,

ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK-së e datës 19.05.2020 dhe detyron të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditësve të datës 06.03.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 614/2022 të datës 06.03.2020 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 19.05.2020 me numër protokollit 938/2020; Autorizimi i datës 16.07.2019; Autorizimi i datës 16.07.2019; Vendimi me nr. protokollit 276 i datës 03.02.2020 i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës dhe Aktgjykimi A.nr.887/2020 i datës 22.04.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, ***nuk është kompetent*** për të vendosur për ankesën A.nr.74/2020 të datës 06.03.2020 të parashtruar nga ankuesit.

Nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar se ankuesit janë të punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në Fakultetin e Arteve.

Ankuesit me datë 06.12.2019 kanë parashtruar kërkesë pranë Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", lidhur me kompensimin e shujtës. Këshilli Drejtues me datën 03.02.2020 ka njoftuar përfaqësuesit e ankuesve se ka nxjerrë vendimin me nr.276 me të cilin ka refuzuar kërkesën e datës 06.12.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranueshmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 3 ku përcaktohet se 3. ***Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në***



administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike të arsimit të lartë të Kosovës, kanë statusin e nëpunësit të shërbimeve publike, respektivisht të njëjtit nuk janë nëpunës civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për praninë në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.74/2020 të datës 06.03.2020 të parashtruar nga ankuesit si në dispozitiv të vendimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publikë me status të nëpunësit të shërbimit publik kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.74/2022, datë 24.06.2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMËTI



Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Përfaqësuesve të autorizuar të ankuesve,
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

